

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-8/10

Prishtinë

12 korrik 2011

Në çështjen juridike të:

H.F.Z.

Parashtruesi i ankesës

Kundër

R.S.M.

Parashtruesi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Kryetarja e Kolegjit Antoinette Lepeltier-Durel, si dhe nga Gjyqtarët Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, duke vendosur me ankesën e ushtruar kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KKPK/D/A/8/2008 (dosja e regjistruar në AKP si KPA 33438), e datës 22 shkurt 2008, në seancën gjyqësore të datës 12 korrik 2011, muarr këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Pranohet si e bazuar ankesa e H.F.Z., e ushtruar me datë 22 nëntor 2010 kundër vendimit KKPK/D/A/8/2008, i datës 22 shkurt 2008.
- 2- Anulohet vendimi KKPK/D/A/8/2008, i datës 22 shkurt 2008, në pjesën që i referohet lëndës së AKP-ës së regjistruar nën numrin KPA33438.
- 3- Refuzohet kërkesa e parashtruar nga R.S.M. me datë 28 mars 2007, e regjistruar pranë AKP-ës nën numrin KPA33438.
- 4- Shpenzimet e procedurës në shumën prej € 45 (katërdhjetëpesë euro) do të mbulohen nga pala përgjegjëse në ankesë, R.S.M., dhe të paguhet në Bugjetin e Kosovës mbrenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Çështjet faktike dhe procedurale:

Me 28 Mars 2007, R.S.M., në emër dhe për llogari të babait të saj S.M.M., ka paraqitur një **kërkesë pronësie** në Agjencionin Kosovar të Pronës (AKP), duke kërkuar **riposedimin** e ngastrës kadastrale nr. 274, në sipërfaqe prej 0.10.19 ha, në vendin e quajtur "Kljuç pod nasip", Zona Kadastrale e Zakut. Ajo pohoi se babai i saj ka humbur posedimin e kësaj parcele si rezultat i rrethanave nga konflikti në Kosovë me 26 mars 1999.

Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur certifikatën e martesës të lëshuar nga Komuna e Majdanpekut, Serbi, me 26 mars 2007 dhe fletën poseduese no. 16 të datës 21 qershor 2002, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e komunës së Podujevës duke vënë në pah se ngastra kadastrale ishte e regjistruar në emër të S.M..

Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin e tij KKPK/D/A/8/2008 datë 22 shkurt 2008 ka vendosur që S.M. është pronar i palujtshmërisë që është objekt i kërkesës së paraqitur dhe se ai ka pas të drejtën e posedimit mbi këtë parcel. KKPK-ja, gjithashtu ka vendosur që mbrenda 30 ditëve nga dita e pranimit të urdhërit të lirohet palujtshmërija nga cilido person që e ka uzurpuar atë në mënyrë të paligjshme, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Paraqitësi i kërkesës (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) ka pranuar vendimin e KKP-ës dhe me datë 6 shkurt 2009 ka paraqitur kërkesë për administrimin e palujtshmërisë nga AKP-ja.

Më 22 nëntor 2010, kundër vendimit të sipërpërmendur, H.Z., ka ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme.

Në ankesën e tij ai pretendon se vendimi i ankimuar përmban gabime shkelje thelbësore të LPP, zbatim të gabuar të ligjit, duke deklaruar se atij i është pamundësuar për të qenë palë në procedurën në shkallë të parë, dhe se për rrjedhojë ky vendim është marrë me konstatin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes. Ajo ka pohuar se babai i saj dhe ajo e kanë blerë parcelen kontestuese nga S.M. në vitin 1981, kanë paguar çmimin që gjë që i ka mundësuar shitësit të blejë traktor, por ai nuk ka mundur të regjistrojë këtë kontratë për shkak të zbatimit të ligjeve diskriminuese të asaj kohe. Ajo ka cekur se kontrata është djegur së bashku me shtëpinë gjatë luftës.

Në mbështetje të ankesës së vet, ai i ka propozuar Gjykatës Supreme deklaratat e 5 dëshmitarëve dhe vërtetimin për të vërtetuar se shtëpia e F.Z. është djegur gjatë luftës.

Me 16 Dhjetor 2010, pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur përgjegje në ankesë, duke e konfirmuar deklaratën e ankuesit.

Arsyetimi ligjor:

1- Ankesa është e pranueshme.

Sipas Nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave të cilat lidhen me pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu pronën bujqësore dhe atë komerciale, pala mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit mbi vendimit.

Në përputhje me nenin 10.3 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 të amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079: *“Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës.”*

Në rastin konkret, as kërkesa e parashtruar dhe as vendimi i KKP-ës nuk i është dorëzuar ankuesit.. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se ai ka ushtruar ankesën e tij sa me shpejtë që ka

mundur pasi është vënë në dijeni të paraqitjes së kërkesës dhe vendimit të KKKPK-ës. Andaj, Gjykata konstaton se ai ka ushtruar ankesën mbrenda afatit kohor.

Meqenëse, ankuesi pretendon se ai është pronar i palujtshmërisë kontestuese, ai ka inetersin juridik në kërkesën e paraqitur.

Prandaj ankesa e tij është e pranueshme.

2- Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se deklarata e ankuesit dhe deklaratat e S.Z., M.Z., H.Z., M.Z. dhe S.G. janë konfirmuar nga përgjegjja e palës përgjegjëse në ankesë dorëzuar me 16 Dhjetor 2010. Pala përgjegjëse në ankesë ka konfirmuar gjithashtu se babai i saj ka pranuar shumën e gjithmbarshme të çmimit të shitëblerjes së kësaj palujtshmërije. Për më tepër, ankuesi, me certifikatën nr. 08-96-07 të datës 8 Pril 2003, lëshuar nga Drejtoria për Rindërtim, Planifikim dhe Zhvillim i Komunës së Podujevës ka vërtetuar se shtëpia e F.Z. është djegur gjatë luftës.

Për më shumë, në përgjegjen e saj në ankesë pala pargjegjëse thekson se meqenëse palujtshmërija ende nuk është regjistruar në emrin e blerësit, F.Z., dhe edhe më tutje është regjistruar në emrin e babait të saj, ajo autorizon dhe bile i kërkon blerësit ose trashëgimtarit të tij të ndërmarrë veprime të nevojshme me qëllim të transferimit të së drejtës së pronësisë në të dhe që në këtë mënyrë ajo jep pëlqimin për këto veprime. Ajo pohon se shitja e ngastrës kadastrale ka përfunduar në vitin 1981, se blerësi ka ndërtuar shtëpinë e tij në të dhe që nga atëherë gjithçka ka qenë në rregull. Ajo ka thëksuar se është gabim i saj që në kuadrin edhe të parcelave të tjera ka përfshirë edhe këtë parcel për të cilën ajo ka paraqitur kërkesë në AKP dhe që ajo nuk e ka në posedim kontratën e shkruar për shkak të konfliktit të armatosur gjatë të cilit babai i saj dhe vet ajo janë detyruar të lëshojnë Kosovën pa pasur mundësinë që të marrin me vete edhe dokumentet.

Nga konfirmimi i këtyre deklaratave, Gjykata Supreme konkludon se parcela kadastrale nr. 274 e Zona Kadastrale e Zakut është blerë nga F.Z. në cilësinë e blerësit nga S.M. në vitin 1981, se shitësi ka paguar në tërësi çmimin kontraktues të shitëblerjes dhe që detyrimet nga kontrata janë plotësuar përgjithmonë.

Gjykata Supreme pranon se palët janë në pamundësi dhe jo për fajin e tyre që të dorëzojnë kontratën e shkruar për shkak të arsyeve plotësisht të pavarura nga vullneti i tyre.

Gjykata Supreme nga deklarata e palës përgjegjëse në ankesë poashtu vëren se ajo pajtohet me ankesën dhe nuk parashtron më faktet në lëndë të cilat paraprakisht i janë paraqitur KKPK-ës.

Rrjedhimisht mbi të mësipërme vendimi i ankimuar nr. KKPK/D/A/8/2008 që I referohet kërkesës së palës përgjegjëse në ankesë e regjistruar në AKP KPA33438 është marrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, vendimi I ankimuar I KKPK-ës është anuluar dhe kërkesa e paraqitur me datë 28 mars 2007 është refuzuar.

Shpenzimet e procedurës:

Sipas Nenit 8.4 të Aneksit III të Urdhresës Administrative (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës pranë Sekretariatit ekzekutiv ose Komisionit, në favor apo kundër ndonjë pale në procedurë .

Megjithatë, ky lirim nuk parashihet për procedurën pranë Gjykatës Supreme

Si rezultat i kësaj, zbatohet regjimi i rregullt i shpenzimeve gjyqësore i përcaktuar me Ligjin mbi shpenzimet gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 3, tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me unifikimin e shpenzimeve gjyqësore, edhe për procedurën pranë Gjykatës Supreme.

Kështu, në këtë procedurë të apelit zbatohen këto shpenzime gjyqësore:

- Tarifa nga taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA nr. 2008/2): në vlerë prej 30 €
- Tarifa nga taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA nr. 2008/2), duke marrë parasysh faktin që vlera e pasurisë në fjalë vlerësohet të jetë në mes 1.001 dhe 2.500 €: në vlerë prej 15 €.

Këto shpenzime gjyqësore duhet të barten nga pala përgjegjëse në ankesë e cila e humb rastin.

Sipas Nenit 46 të Ligjit mbi shpenzimet gjyqësore, afati për pagesën e shpenzimeve nga personi që banon jashtë vendit nuk mund të jetë më pak sesa 30 ditë dhe jo më shumë sesa 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në këtë rast, shpenzimet gjyqësore të paguhen nga parashtruesi i ankesës në afat prej 90 ditësh që nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet as me mjete të rregullta as të jashtëzakonshme juridike.

Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit të EULEX-it

Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Holger Engelman, Regjistrues i EULEX-it.